



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 724/7 Prot.

Patos, më 27/04 2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 24 PRILL 2024

Vendi: "Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak"

Ora e fillimit : 14:00

Ora e mbarimit : 15:30

Tema e Konsultimit: "Përcaktimin e kritereve dhe procedurave për ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe mënyrës së organizimit të funksionimit të tij".

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit me nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë" dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Pjesëmarrës: Kryetar i Bashkisë z. Fation Duro, Sekretare e Këshillit znj. Rafaela Xeba, Koordinatore e Konsultimit Publik znj. Suzana Hysenaj, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, Drejtore e Integritimit European, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve znj. Elda Goxhaj, stafi i njësisë së Integritimit European, të rinj të qytetit dhe Njësi Administrative Zharrëz dhe Ruzhdie, grupe interesi.

Takimin hapet nga Drejtore e Integritimit European, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve znj. Elda Goxhaj:– Të nderuar pjesëmarrës më lejoni së pari t'ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ me temë: "Përcaktimin e kritereve dhe procedurave për

ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe mënyrës së organizimit të funksionimit të tij” i cili realizohet në zbatim nën 18 dhe 52 të ligjit me nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe ligji për rininë dhe në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë” dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij dhe konsiston në informimin e të rinjve dhe qytetarëve lidhur me kriteret dhe procedurat e ristrukturimit të Këshillit Vendor Rinor. Fjalën do të doja t’ja kaloja Kryetarit të bashkisë.



Drejtoreshë e Integritetit Europian, Arsimit,
Kulturës dhe Sporteve
Znj. Elda Goxhaj

Dëgjuesë Publike me temë :

*Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për
ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe
mënyrës së organizimit të funksionimit të
tij”.*

Prill 2024

Kryetari i bashkisë Z. Fation Duro – Si fillim do të doja të falenderoja të gjithë të rinjtë pjesëmarrës, të cilët luajnë një pikë kyçe në shoqëri. Dua t’ju përgëzoj dhe shpreh vlerësimin tim për aktivizimin dhe seriozitetin që tregoni në aktivitetet që organizon bashkia dhe gjithashtu ju inkurajoj që të vazhdoni dhe të jeni shembull për gjithë të rinjtë e tjerë. Për më shumë detaje lidhur me Këshillin Vendor Rinor, Elda mund të vazhdojë.



**Kryetari i bashkisë
Z. Fation Duro**

Dëgjuesë Publike me temë :

*Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për
ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe
mënyrës së organizimit të funksionimit të
tij”.*

Prill 2024

Drejtoreshë e Integritetit Europian, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve Znj. Elda Goxhaj: – Këshilli Vendor Rinor është një organ këshillimor pranë kryetarit të bashkisë, të cilit paraqet propozime në lidhje me çështjet e të rinjve dhe jep një mendim jo-detyrues në lidhje me

rininë. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës së funksionimit dhe organizimit të brendshëm të Këshillit Vendor Rinor (KVR). Jemi të lumtur që kemi qenë ndër bashkitë e para në Republikën e Shqipërisë që kemi konstituuar KVR dhe që jemi sot sërish para jush, brenda afateve ligjore për të ristrukturuar këtë organ. Do të doja të shprehja falenderim për të gjithë anëtarët e KVR të cilët janë: Veip Kamberaj, Aldon Beqaj, Eneo Mahmuti, Aida Vidhishta, Teuta Sako, Valbona Mamo, Fabian Bilaj, Pranvera Jajaj, Jonela Myrtaj. Shkurtimisht dua t'ju bëj një prezantim me informacione të përgjithshme lidhur me KVR dhe dua t'ju theksoj faktin që për cdo paqartësi lidhur me mënyrën e aplikimit për të qenë pjesë pasi të shpallet në faqen zyrtare të bashkisë, ne do të jemi për t'ju ndihmuar.

Kush mund të jetë anëtar i KVR? Mund të jenë anëtarë me të drejta të plota të rinjtë në moshën 15 deri në 29 vjeç, të cilët shprehin vullnetin dhe interesin për t'u bërë pjesë e Këshillit. Numri i pjesëmarrësve është i pakufizuar në numër, ku minimumi duhet të jetë 4 anëtarë. Cdo anëtarë mund të japë dorëheqjen në cdo kohë duke njoftuar me shkrim kryetarin. Anëtar i KVR ka të drejtën e votës dhe ka të drejtën të parashtrojë propozime për diskutim apo rekomandime për zgjidhje problematikash që kalojnë në miratim. Sic e thashë dhe më parë gjatë fazës së aplikimit ku duhet të dorëzoni disa dokumenta të cilat do të jenë të listuara në momentin që do të hapet thirrja, do të keni ndihmën tonë për cdo paqartësi. Fjala për ju tani për cdo pyetje që keni.

Nxënës i shkollës “Zhani Ciko” Sokol Baxhia : - Si fillim do të doja të falenderoja bashkinë për të gjitha aktivitetet që organizon dhe që i jep fuqi zërit tonë. Do të doja të falenderoja Kryetarin e bashkisë i cili sa herë që ne si të rinj kemi kërkuar takim me të, na ka



Nxënës i shkollës “Zhani Ciko”


Sokol Baxhia

Dëgjese Publike me temë :
*Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave
për ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor
dhe mënyrës së organizimit të funksionimit
të tij”.*


Prill 2024

pritur me shumë dashamirësi dhe na ka dhënë zgjidhje. Unë si i ri aktiv i qytetit të Patosit dhe duke qenë se i plotësoj kriteret që Elda shpjegoi, do të doja dhe do të aplikoj që të bëhem pjesë e KVR.

Nxënës i shkollës “Sotir Çapo” Anxhela Mamo- mbi aplikimin për t’u bërë një anëtare e Këshillit Vendor Rinor, unë do të kisha shumë dëshirë të aplikoja dhe të bëhesha pjesë për të marrë pjesë në disa nisma dhe aktivitete.

	<p>Nxënës i shkollës “Sotir Çapo” Anxhela Mamo</p> <p>Dëgjesë Publike me temë :</p> <p><i>Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe mënyrës së organizimit të funksionimit të tij”.</i> Prill 2024</p>
---	---

Drejtores e Integritimit Europian, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve znj. Elda Goxhaj: – ti je një e re shumë aktive në aktivitetet që organizon bashkia Patos dhe do të ishte me shumë vlerë për ne që të bëheshe pjesë e KVR -së dhe ne e vlerësojmë kontributin tënd si e re në pjesëmarrjen aktive në cdo aktivitet.

	<p>Drejtores e Integritimit Europian, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve znj Elda Goxhaj</p> <p>Dëgjesë Publike me temë :</p> <p><i>Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe mënyrës së organizimit të funksionimit të tij”.</i> Prill 2024</p>
--	---

Anëtarë i Këshillit Bashkiak z. Erald Cepele: - unë kisha një pyetje në fakt lidhur me afatin e Këshillit Vendor Rinor. Sa zgjat mandati i anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor?

	<p>Anëtarë i Këshillit Bashkiak z. Erald Cepele</p> <p>Dëgjesë Publike me temë :</p> <p><i>Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe mënyrës së organizimit të funksionimit të tij”.</i> Prill 2024</p>
---	--

Drejtoresha e Integritetit Europian, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve znj Elda Goxhaj:– Ashtu sic edhe e përmenda më herët mandati i anëtarëve të KVR është 2-vjecar , pra pas dy vitesh ata rizgjidhen dhe përgjatë kohës së mandatit nëse ata nuk janë aktiv mund të zbriten nga detyra.



Drejtoresha e Integritetit Europian, Arsimit,
Kulturës dhe Sporteve
znj Elda Goxhaj

Dëgjuesë Publike me temë :

*Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për
ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe
mënyrës së organizimit të funksionimit të tij”.*
Prill 2024

Nxënës i shkollës “Sotir Çapo” Reivi Mamo: - unë si një i ri kam shumë dëshirë të aplikoj, por do të doja nga ana juaj një njoftim në mimentin që do të hapet thirrja dhe nëse mund të na ndihmoni në procesin e aplikimit pasi e kam pak të paqartë procesin.



Nxënës i shkollës “Sotir Çapo”
Reivi Mamo

Dëgjuesë Publike me temë :

*Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për
ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe
mënyrës së organizimit të funksionimit të tij”.*
Prill 2024

Nxënës i shkollës “Meleq Gostinishti” Xhoeljo Mukaj : - unë do të kisha shumë dëshirë që të bëhesha pjesë e KVR-së, por duke qenë se nuk e përmbush kriterin e moshës kjo më penalizon nga mundësia për të aplikuar.



Nxënës i shkollës “Meleq Gostinishti
Xhoeljo Mukaj

Dëgjuesë Publike me temë :

*Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për
ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe
mënyrës së organizimit të funksionimit të tij”.*
Prill 2024

Nxënëse e shkollës “Zhani Ciko” Sibora Ballaj: - unë do të kisha shumë dëshirë që të aplikoj dhe të kontribuoj në të rinjtë e vendit tim duke sjell ide të ndryshme dhe dua të jem sa më aktive, prandaj do të aplikoj dhe uroj shumë që të përzgjidhen si kandidat e KVR-së.



**Nxënëse i shkollës “Zhani Ciko”
Sibora Ballaj**

Dëgjesë Publike me temë :

*Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për
ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe
mënyrës së organizimit të funksionimit të
tij”.*

Prill 2024

Drejtoresha e Integritimit Europian, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve znj Elda Goxhaj:- Faleminderit të rinjëve të cilët e shprehën këtu dëshirën dhe vullnetin e tyre për të qenë kandidat për KVR-në. Dikush tjetër që ka ambicie për të qenë pjesë e këtij këshilli. Padiskutim që drejtoresha e arsimit dhe sektori i integritimit do të jenë mbështetës dhe orientues në plotësimin e dokumentacioneve apo printime të tyre për kandidatët. Ne na kemi këtu për çdo paqartësi të procesit, nëse nuk kemi gjë tjetër për të shtuar e deklaroj këtë takim konsultativ të mbyllur dhe suksese të gjithë pjesëmarrësve në proces.

Konceptoi:

Koordinator i Konsultimit Publik

Suzana Hysenaj

Pranoi:

Sekretar i Këshillit

Rafaela Xeba

Foto të dëgjesës publike me temë: “Përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për
ristrukturimin e Këshillit Vendor Rinor dhe mënyrës së organizimit të funksionimit të tij”.

